



Pas përfundimit të ndeshjes Kastrioti-Laci të zhvilluar në qytetin e Krujës, trajneri i Kastriotit, Ramadan Ndreu, ka dhënë dorëheqjen nga të gjitha detyrat që ai kryente . Sipas tij konfirmohet largimi nga cdo funksion që ai kryente me skuadren e Kastriotit. Kjo nuk është hera e parë që Ndreu është larguar nga drejtimi i skuadres dhe ka dhënë dorëheqjen shumë herë të tjera më përpara. "Jap dorëheqjen. Janë një sërë problemesh që më detyrojnë të largohem dhe të marrë këtë vendim", është shprehur Ndreu pas humbjes me Laçin.